

Raport për rezultatet e konsultimeve publike

1. Titulli i draft aktit

Projektligji ‘Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 107 datë 27.10.2016 “Për prefektin e qarkut”’.

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Specifikoni kohëzgjatjen e përgjithshme të konsultimeve publike sa i përket ditëve të punës, përfshirë datën e hapjes dhe mbylljes së konsultimeve publike; nëse kohëzgjatja ishte më e shkurtër se 20 ditë pune e paraparë me ligj, jepni arsye për shkurtimin e kohëzgjatjes.

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 107 datë 27.10.2016 “Për prefektin e qarkut”, i ndryshuar”, propozohet në kuadër të rritjes së efikasitetit dhe konsolidimit të performancës së prefektit të qarkut. Për këtë qëllim është ngritur grupi i punës dhe takimi i parë i tij është zhvilluar me datë 31 gusht 2023 në ambientet e Ministrisë së Brendshme.

Projektligji është hartuar nga Drejtoria e Politikave të Çështjeve Vendore dhe Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator në Ministrinë e Brendshme, përgjatë muajit gusht - tetor 2023, duke zhvilluar takimet në Ministrinë e Brendshme. Projektligji është dërguar për mendim tek ministritë e linjës, në fund të muajit shtator 2023.

Konsultimi publik në RENJK do të jetë për periudhën kohore në respektim të ligjit, nga data 26 tetor 2023 deri më datë 26 nëntor 2023.

3. Metoda e konsultimit

Listoni të gjitha metodat e konsultimit të përdorura, të tilla si konsultimet elektronike (Regjistri Elektronik, posta elektronike, faqet e internetit, etj.), Takimet publike, seancat e organeve këshilluese..., dhe siguron informacione për afatin kohor, kohëzgjatjen dhe afatet e tyre. Shpjegoni se si u shpërnda informacioni mbi konsultimet e hapura, si u ftuan palët e interesuara të kontribuojnë. Përfshini gjithashtu aktivitetet nga konsultimet paraprake nëse janë organizuar të tilla).

Metodat e konsultimit të përdorura për projektvendimin **Projektligji ‘Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 107 datë 27.10.2016 “Për prefektin e qarkut”’**, janë dy:

1. Konsultimi elektronik, përmes Regjistrisë Elektronike për Njoftimet dhe Konsultimet, RENJK.

2. Takime me grupin e punës me datë 31 gusht 2023. Ky takim u zhvilluar për të diskutuar lidhur me modalitetet, afatet dhe hapat që duhen ndjekur për përgatitjen e draftit.

4. Palët e interesit të përfshira

Palët e interesuara të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike gjatë procesit të hartimit, janë:

1. Grupi i punës ngritur me urdhërin nr. 58, datë 28.04.2023, “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e projektligjit “Për disa ndryshime në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”.
2. Drejtori dhe specialistët e Drejtorisë së Politikave të Çështjeve Vendore.
3. Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore.

5. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/ refuzuara

Gruponi komentet/ propozimet e pranuar sipas çështjes që ato ngritën;

Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato;

Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.

<i>Çështja e adresuar (psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)</i>	<i>Komenti (grumbulloni dhe përmbliidhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)</i>	<i>Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)</i>	<i>Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)</i>	<i>Justifikimi</i>

--	--	--	--	--